



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KRYETARI I KOMUNËS
01-Nr-
ME DATE: 05.10.2022

Komuna e Mamushës duke u bazuar në nenin 34 pika 12 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 nenin 18 pika 1 dhe 2 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrieren në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Udhëheqësi më i lartë Administrativ bënë :

VAZHDIM SH PALLJE PUBLIKE

- I. Për angazhimin e ekspertit të jashtëm, për të qenë pjesë e Komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të kandidatëve për konkurset në pranim, ekspert të burimeve njerzore nga organizata të specializuara apo Univerzitet të fushës.

Lokacioni vendi i punës Komuna e Mamushës

Paga fikse është: 250 Euro për ekspertin e angazhuar e cila paguhet për procedurën (grupin) e konkurimit.

Mandati do të jetë dy (2) vjeçar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i komisionit për pranim në shërbimin civil dhe do të kryej detyrat e tij ashtu si janë përcaktuar në rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrieren në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e që janë:

- Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit dhe përvojës domethënëse në punë.
- Vlerësimin e trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse.
- Vlerësimin e njohurive, aftësive apo cilësitë e kandidatit , nëpërmjet intervistës me gojë.

Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Diplomë universitare në fushën : Burime Njerzore ose të Universitetit të fushës (Ekonomik, Juridik, Administratë Publike) me të paktën 240 kredi.
- Kontrata ose vërtetim që dëshmon marrëdhënjen e punës me Universitete të fushës.
- Për personat që kanë diplomuar jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës nga MASHT-i.
- Së paku 4 vite përvojë pune pas diplomimit, në fushën profesionale të nivelit drejtues.
- Të mos jenë të emëruar politik
- Të mos jenë shërbyes civil
- Të ket inegritet moral dhe profesional
- Të mos jet i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ket mas disiplinore në fuqi.
- Të drejtë konkurimi kanë kandidat nga organizatat të specializuara apo universitetet e fushës.

Angazhimi në cilësinë e ekspertit të jashtëm nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Komunën e Mamushës, mirëpo eksperti do të angazhohet për një periudhë të caktuar kohore.

Mënyra e aplikimit:

Kandidatet e interesuar duhet të paraqesin këto dokumente:

Kopjen e letërnjoftimi

- Një CV
- Dëshmi për shkollimin fotokopje e diplomes e vertetuar
- Dëshmi për përvojën e punës
- Dëshmi që nuk është nën hetime
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatët që aplikon.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Mamushës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Mamushës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk hyjnë në përzgjedhje nuk do të kontaktohen.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Mamushës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kryetari i Komunës

Abdullahi Krasniç

